



URDHËR

Nr 402/1, Datë 27.03.2015

PËR

**CAKTIMIN E PERSONIT TË KONTAKTIT PËR TË DHËNAT PERSONALE DHE
KOORDINATORIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT NË UART**

Në mbështetje të nenit 3 e 21, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, pikës 1, gërma b, Udhëzimit nr. 21, datë 24.09.2012, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj", i ndryshuar, nenit 10, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit",

URDHËROJ:

1. Personi i kontaktit për përmbushjen e detyrimit për njoftim për të dhënat personale që përpunohen në Universitetin e Arteve (UART) dhe koordinatorit për të drejtën e informimit, të jetë **Zj. Elia ADEMI/PLAKU** Drejtore e menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
2. Personi i kontaktit të marrë masat e nevojshme për zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit në UART.
3. Me njohjen e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e UART.
5. Ky urdhër hartohet në tre kopje të njëjta, një për Protokoll/Arkivin e UART, një për personin e kontaktit dhe një kopje për Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Petrit MALAJ
REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE
TIRANË